



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari", pn, vvvgjilani-komuna.org; zip gjilan@hotmail.com, tel. 028/20 781, 20 782, 21 482.

Në bazë të nenit 17. pika b) c) d) dhe e) të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28, dt. 04. qershor /2008), nenit 17 dhe nenit 26 pika 3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim të Hapsinor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 30/ dt.28.gusht 2013, Udhëzimit Administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikimin hapësinor mbi elementet e themelore të Planit Rregullues Urban, nr. rend. 41, nr. prot.02/05, nenit 38.1. (b,c,d.) të dhe nenit 38. pika 1.2.-1.5) dhe nenit 39. pika1.4) të Statutit të Komunës së Gjilanit, e në vështrim të Vendimit nr. 01.11735, për miratimin e Planit Rregullues Urban: "Qyteti i Gjilanit" të dt. 30.10.2008, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më datë: 29.09.2014, miraton këtë:

V E N D I M

Mbi qasjen e Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm: " Qendra -4", në Gjilan

1.

Me këtë Vendim i qaset hatrimin të Planit Rregullues të Hollësishëm të lokacionit: " Qendra - 4", në Gjilan (në tekstin e mëtejshëm: PRrH: "Qendra-4", i cili përfshinë hapësirën, në sipërfaqe prej, S= 28.00 ha. (Njëzetetë hektar).

2.

PRrH: "Qendra -4 ") përfshinë hapësirën nga rrethrrrotullimi përballë Xhamisë së Vogël, përkatësisht nga pikat e Koordinatave $x=7538708.630$ dhe $y= 4702645.029$, vazhdon përgjatë rrugës: " Mulla Idrizi" në drejtim të Lagjës së "Zabelit" deri të Kufijt e rrethojës së Fabrikës së Radiatorëve, pikat e koordinatave $x=7539213.111$ dhe $y=4702108.868$, ku kthehet në të djathtë përgjatë murit rrethoj deri të kompleksit të Kombinatit të Tekstilit "Integj", te pikat e koordinatave: $x= 7538919.459$ dhe $y=4701984.293$, ku kthehet në të majt duke përcjell kufirin e PRrH " Zabeli-1" deri në pikën at e koordinatave: $x=753896.030$ dhe $y=4701477.034$, kthehet në të djathtë deri të rruga Gjilan-Preshevë, përkatësisht pikat e koordinatave: $x=7538745.275$ dhe $y=4701415439$ ku kthehet në të djathtë në drejtim të Qendrës deri të pika Fillëstare të Xhamisë së Vogël $x=7538708.630$ dhe $y=4702645.092$, në tërësi sipas paraqitjes grafike, e cila është pjesë përbërse e këtij vendimi.

3.

PRrH: " Qendra - 4", duhet të jetë në përputhje me Planin Zhvillimor Urban të Qytetit të Gjilanit, përkatësisht Hartën Zonale të Komunës.

PRrH: " Qendra - 4", duhet të përmbajë: pjesën tekstuale dhe grafike;

4.

Gjatë hartimit të këtij plani, veçmas duhet të sigurohet:

- harmonizimi i organizimit, rregullimit dhe i shfrytëzimit të hapësirës dhe tokës ndërtimore;
- harmonizimin dhe inkorporimin e gjendjes dhe ndërtimeve ekzistuese si dhe organizimin e ndërtimeve të reja përbrenda kufinjëve të ngastrave kadastrale përkatësisht ndërtimore, duke patur parasysh kushtet urbanistiko teknike dhe hapësirë si dhe oportunitetin e interesave publiko-private;
- organizimin e ndërtimeve të objekteve të infrastrukturës sociale karakterit të përgjithshëm publik me përmbajtje përcjellëse (objekteve të asrimit, edukimit, shëndetësisë, mirëqenjes sociale, kulturës, sportit, rekreacionit, administratës publike etj);

- organizimin e ndërtimeve të objekteve të infrastrukturës komunale më përbajtje përcjellëse (rrugëve, gjelbrimit public, hapsirave të lira, rrjeteve të ujësjellsit, kanalizimit fekal dhe atmosferik, rrjetit të përqesve elektrik, telekomunikes, optik etj);
- mbrojtjen dhe përparimin i vlerave mjedisore, natyrore dhe vlerave të krijuara me punë;
- mbrojtjen e ambientit jetësor;
- ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të resurseve dhe pasurive natyrore,
- mbrojtjen nga fatkeqësitë elementare;
- kushtet hapsinore dhe të planit për realizimin e masave me interes të përgjithshëm shoqëror;

5.

Bartës i hartimit të planit caktohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Gjilanit.

6.

Bartësi i hartimit të planit sipas pikës 5. të këtij vendimi, është i obliguar që planin ta hartojë në afat prej 1 viti, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7.

Drafti i Projekt Planit, duhet vënë në shqyrtim public dhe komentim në kohëzgjatje jo më shumë se 30 ditë.

Paraqitja e planit për shqyrtim public dhe koha për dhënjen e komenteve duhet të shpallen në mjetet e informimit.

8.

Financimi i hartimit të këtij plani do të bëhet nga mjetet buxhetore të KK-ës së Gjilanit.

9.

Plani do të hartohet për periudhën 8 vjeqare, me mundësi rishikimi pas 8 viteve.

10.

Elaborati i këtij plani do të hartohet në 5 kopje të origjinalit në formë tekstuale dhe 5 kopje elektronike.

11.

Mbi zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Gjilanit.

12.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Nr. 016-112985
Gjilan, më 29.09.2014.

Kryesuesja e Kuvendit,
_____,
Valentina Bunjaku-Rexhepi

A r s y e t i m

i

Propozim Vendimit për qasjen e hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm: " Qendra 4" në Gjilan

Bazë juridike për miratimin e Vendimit mbi qasjen e hatimit, të Planit të Rregullativ të hollësishëm " Qendra-4" e qytetit të Gjilanit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17 dhe neni 26 pika 3 dhe 4 e Ligjit për Planifikimin e Hapsinor, nr. 04/L-174 si dhe Statuti i Komunës së Gjilanit, në bazë të së cilave Komunitat obligohen që në afatin prej 15 mujve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Ligji të aprovojnë dokumentet e Planifikimit hapësinor në pajtim me dispozitat e këtij Ligji.

Për shkak të kërkesave të shtuara të qytetarëve për ndërtimin e objekteve shumëbanesore, e në mungesë të planeve adekuate dhe të tejkaluara në këtë pjesë të qyteti, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në vitin 2008 ka nxjerr Vendimin për miratimin e Planit Rregullues Urban të "Qytetit të Gjilanit" me synim që në të ardhmen të bëhet revidimi dhe harmonizimi i Planeve ekzistuese si dhe hartimi i Planeve të reja, me qëllim të krijimit të kushteve dhe mundësive që qytetarëve të iu krijohej mundësia e ndërtimit të objekteve në mënyrë të planifikuar.

Meqenëse ndërkohë janë miratuar Plane Rregulluese Urbane për disa lokacione, ndërsa janë në proces të revidimit edhe disa Plane Rregulluese të Hollësishme, sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor (nr. 4/L-174 të datës 23.Gusht/2013) si dhe mosrealizimit të Planeve të mëherëshme për shkak të gjendjes së krijuar me rastin e ndërtimit të objekteve industriale dhe përpunuese nga Investuesit që kanë qeverisë me pronën Shoqërore si: Fabrika për përpunimin e Miellit, Fabrika e Konstruksioneve Metalike, "Gosha-Metaliku", Kompleksi i Kombinatit të Tekstilit "Integj" dhe Fabrika e Radiatoreve, si dhe Privatizimi i tyre si dhe kërkesat e pronarëve të rinjë për investime dhe ndërtim të destinimeve e në këtë kontekst edhe riorganizimi i kësaj hapësire në përputhe me kushtet bashkohore, planifikimi objekteve të infrastrukturës teknike dhe sociale, duke u marrë në konsideratë destinimi, funksionaliteti ndërlidhja dhe interferimi i kësaj hapësire me hapësirat për rreth mvarësisht nga destinimi që do të parashifet.

Duke u nisur nga shkaqet e lartpërmendura e duke u bazuar në obligimin dhe mundësinë që i ofron Ligji i ri për Planifikim Hapësinor, e me qëllim të funksionalizimit, shfrytëzimit sa më racional dhe përmbajtësor të kësaj hapësire e mbi të gjitha, krijimin e kushteve dhe mundësive që me një qasje të re në procesin e planifikimit duhet marrë në konsideratë pronat dhe objektet ekzistuese për aq sa lejojnë kriteret e planifikimit urban dhe rregullimit të hapësirës të krijohej një partneritet i qëndrueshëm në relacionin Qytetar-Komunë i cili do të rezultonte me realizimin sa më të mirë të planit të ri.

DREJTORIA PËR URBANIZËM, RINDËRTIM DHE AMBIENT

G J I L A N

Gjilan, Shtator / 2014